



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 1888 Prot.

Patos, më 20/06/2025



**MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro**

PROJEKTVENDIM

Nr. 30, datë 20/06 /2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT
PËR PERIUDHËN 2025-2027**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", pikës 1, të nenit 28, gërmës "a", të pikës 2, të nenit 33, të gërmës "k", të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar dhe VKM nr. 859, datë 26.12.2024 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performanës" Bashkia Patos ka hartuar Planin e Integritetit në kuadër të asistencës për forcimin e etikës dhe integritetit në qeverisjen vendore. Grupi i punës

PROPOZON

1. Të miratojë Planin e Integritetit për bashkinë Patos, për periudhën 2025-2027.
2. Bashkëlidhur këtij projekt vendimi "Plani i Integritetit i hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë me nr.1668 prot., datë 02.06.2025

Grupi i Punës

Koordinator
Ernesta Hamiti

Anëtar
Mimoza Shtëmbari

Anëtar
Juela Shpata

Anëtar
Çajup Refitaj

Anëtar
Boreta Murati

Anëtar
Florian Kita

Juriste
Nurkë Hazizaj

Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 1888 / Prot.

Patos, më 20 / 06 / 2025

RELACION SHPJEGUES PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INTEGRITETIT

Bashkia Patos ka miratuar me VKB nr. 52, datë 31.08.2023 Planin e Integritetit për periudhën 2023 – 2025. Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operacional, i cili bazohet në identifikimin e risqeve sipas fushave të veprimtarisë së bashkisë dhe vlerësimin e ekspozimit kundrejt praktikave joetike dhe të korrupsionit duke prezantuar masat e nevojshme për përmirësimin e integritetit të bashkisë.

Plani i Integritetit për periudhën 2023 -2025 përfshinte një sërë masash për të adresuar risqet e integritetit të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë Patos si më poshtë;

1. Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
2. Fusha e Menaxhimit Financiar
3. Fusha e Kontrollit, Auditimit dhe e Mekanizmave kundër Korrupsionit
4. Fusha e Shërbimeve Publike
5. Fusha e Planifikimit të Territorit, administrimit dhe menaxhimit të pronave
6. Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumentave

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Integritetit përfshinte masa me afat zbatimi nga 6 mujori i dytë i vitit 2023 deri në 6 mujorin e parë të vitit 2025.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarr aktivitete sipas fushave të përgjegjësisë për realizimin e masave të parashikuara në përfundim të të cilave rezultoi se:

1- Për fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore :

- Me vendimin e kryetarit të bashkisë nr. 263, datë 31.12.2024 është përditësuar Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave me të cilën janë njohur të gjithë punonjësit e administratës
- Kodi i Etikës është përditësuar me vendimin e kryetarit të bashkisë nr.105, datë 24.05.2024
- Pas miratimit të Kodit të Etikës me vendimin e kryetarit nr. 105, datë 24.05.2024 është bërë njohja e administratës me Kodin e Etikës dhe të Sjelljes

2- Për fushën e Menaxhimit Financiar

- Për vitin 2024 është hartuar kalendari për miratimin e PBA ku përcaktohet edhe afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore
- Janë respektuar kërkesat e bazës rregullative në fuqi për krijimin\hartimin e buxhetit vjetor
- Gjatë fazës së parashikimit të Buxhetit, ekipi hartues ka bashkëpunuar me drejtoritë e Bashkisë për të shprehur kërkesat që mund të nevojiten në vijim të vitit ushtrimor

3- Për fushën e Kontrollit, Auditimit dhe e Mekanizmave kundër Korrupsionit

- Janë realizuar trajnime nga stafi i AB për grupin e menaxhimit të riskut.

Janë plotësuar vakancat në Njësinë e auditimit të Brendshëm

4- Për fushën e Shërbimeve Publike

- Kërkesë drejtuar ASPA mbi nevojat e institucionit për trajnime për termat e referencës për shërbime specifike

5- Për fushën e Planifikimit të Territorit, administrimit dhe menaxhimit të pronave

- Është krijuar një listë e pronave në pronësi dhe në administrim të bashkisë dhe po punohet për përditësimin me të dhënat historike.

Në përfundim të afatit të zbatimit të masave të parashikuara dhe në zbatim të VKM nr. 859, datë 26.12.2024 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performanës” grupi i punës i ngritur me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë me nr.1668 prot., datë 02.06.2025 hartoj planin e Integritetit për periudhën 2025 – 2027 sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore.

Për zbatimin e Planit të Integritetit ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë.

Personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit caktohet Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, znj. Ernesta Hamiti.

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë që të miratojë Planin e Integritetit për bashkinë Patos për periudhën 2025 – 2027.

Grupi i Punës

Koordinatorë
Ernesta Hamiti

Anëtar
Mimoza Shtëmbari

Anëtar
Juella Shpata

Anëtar
Çajup Refitaj

Anëtar
Boreta Murati

Anëtar
Florian Kita

KRYETARI
Faton Duro

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Uraza”, Patos



PLANI I INTEGRITETIT

PËR BASHKINË PATOS

2025-2027

Miratuar me Vendimin Nr. _____, datë ____/____/2025

të Këshillit Bashkiak

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Patos

Nr.	Emri	Pozicioni	Roli në grup
1	Ernesta Hamiti	Përgjegjëse, Auditi i Brendshëm	Koordinatore e Grupit të punës
2	Juela Shpata	Drejtores, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit	Anëtare
3	Mimoza Shtëmbari	Drejtores, Drejtoria e Financës	Anëtare
4	Cajup Refitaj	Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit.	Anëtar
5	Boreta Murati	Drejtores, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve	Anëtare
6	Florian Kita	Përgjegjës, Njësia e Prokurimeve Publike	Anëtar

Ky Plan Integriteti është hartuar në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030 dhe Planit të saj të Veprimit.

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Bashkia Patos e konsideron **integritetin institucional** si një tipar thelbësor të qeverisjes së mirë, një element kyç në procesin e integritetit evropian të vendit dhe një bazë të domosdoshme për forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike. Për ne, integriteti institucional nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një standard etik dhe profesional që duhet të reflektohet në çdo veprimtari administrative dhe shërbim ndaj komunitetit.

Gjatë viteve të fundit, Bashkia Patos ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim përmes **hartimit dhe zbatimit të dy Planeve të Integritetit** për periudhat 2019–2022 dhe 2023–2025, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit institucional, përmirësimin e transparencës, forcimin e demokracisë vendore dhe krijimin e një kulture të rezistencës ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e administratës.

Në vijim të këtyre përpjekjeve, Plani i Integritetit 2025–2027 synon të forcojë treguesit e integritetit dhe të krijojë një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e riskut në nivel vendor. Ai do të shërbejë si udhërrëfyes për të identifikuar fushat më të ekspozuara ndaj korrupsionit, për të vendosur masa parandaluese dhe për të zbatuar standarde të larta etike dhe profesionale. Bashkia Patos e mbështet këtë proces përmes planifikimit me pjesëmarrje, duke angazhuar administratën vendore dhe duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe shërbime më cilësore për qytetarët.

Jemi të bindur se integriteti institucional është një domosdoshmëri jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhmen e mirëqeverisjes vendore, ndaj shprehim angazhimin tonë të plotë për zbatimin e Planit të Integritetit 2025–2027, duke e vendosur atë në krye të objektivave strategjike të Bashkisë Patos dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ndershëm të komunitetit që përfaqësojmë.

Kryetari i Bashkisë Patos
Fation Duro



SHKURTESA

AB	Auditimi i Brendshëm
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BNJ	Burime Njerëzore
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
GPI	Grupit të Punës për Integritetin
KI	Konflikti i Interesit
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PI	Plani i Integritetit
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
PSV	Procedura Standarde Veprimi

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Rëndësia e Planit të Integritetit.....	1
1.1	Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	1
1.2	Qasja Metodologjike.....	3
2.	Objektivat e identifikuar dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit.....	3
2.1	Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator, institucional dhe financiar në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit	4
2.2	Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në Bashki, për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit në të gjitha nivelet dhe funksionet.....	4
2.3	Menaxhimi i riskut të integritetit për të gjithë bashkinë, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë.....	4
3.	Plani i Veprimit.....	5

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit përbën një mjet strategjik dhe operacional me rëndësi thelbësore për garantimin e qeverisjes së mirë në nivel vendor. Ai siguron identifikimin dhe menaxhimin e riskut të integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së bashkisë, duke forcuar kuadrin rregullator të brendshëm, etikën institucionale dhe kulturën antikorruption. Nëpërmjet këtij plani:

- Forcohet transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve;
- Promovohet ndershmëria dhe standardet etike në administratën publike;
- Minimizohet mundësia për abuzim dhe veprime korruptive;
- Rritet besueshmëria publike dhe përmirësohet imazhi institucional;
- Sigurohet një sistem i qëndrueshëm për parandalimin dhe menaxhimin e shkeljeve të integritetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

Ky plan shërben si një instrument i domosdoshëm për garantimin e mirëfunksionimit të administratës vendore dhe për ndërtimin e një mjedisi institucional të bazuar në parime të forta etike, transparencë dhe qeverisje të përgjegjshme.

1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit për Bashkinë Patos për periudhën 2025–2027 është hartuar në përputhje me kërkesat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planit Kombëtar të Veprimit për integritetin institucional në nivel vendor. Procesi i hartimit të Planit u zhvillua në mënyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Plani u hartua nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Patos, Nr. 1668 prot., datë 02.06.2025. Në përbërje të këtij grupi ishin përfshirë përfaqësues të administratës vendore nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët kryesorë të institucionit, të cilët u angazhuan në të gjitha fazat e procesit. Procesi përfshiu:

Faza 1: Përgatitjen dhe mobilizimin e burimeve njerëzore, përmes ngritjes së grupit të punës dhe prezantimit të metodologjisë për vlerësimin e riskut të integritetit; Grupi i punës u ngrit nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin me nr. 1668 prot., datë 02.06.2025 dhe përbëhej nga 5 anëtarë të cilët cilët mbulonin fushat kryesore funksionale të Bashkisë Patos . Grupi i punës u kryesua nga një koordinator, i cili siguroi mbarëvajtjen sa më dinamike të procesit, si dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të realizuara në kuadër të procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në bashki. Grupi i punës u prezantua me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) dhe me hapat e punës, si dhe u trajnua mbi çështjet e integritetit dhe etikës në administratën publike. Së fundi, në këtë fazë u bë komunikimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të Integritetit me administratën e bashkisë, nga ana e Grupit të Punës.

Faza 2: Identifikimin dhe analizën e risqeve të integritetit, duke shqyrtuar kuadrin rregullator, dokumentacionin operacional dhe raportet e performancës së bashkisë; Grupi i punës shqyrtoi kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Në këtë fazë, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan diskutime në fokus grupe me punonjës të bashkisë sipas fushave të veprimtarisë së kësaj të fundit.

Faza 3: Vlerësimin e risqeve të integritetit, duke analizuar mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin e tyre në funksionet e institucionit dhe duke i renditur sipas përparësisë; Grupi i Punës kreu vlerësimin e risqeve të integritetit, duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhjes apo shfaqjes së risqeve apo ngjarjeve negative të analizuara, si dhe ndikimin e tyre në integritetin e bashkisë. Procesi vijoi me renditjen e risqeve sipas prioritetit dhe ndarjen e tyre sipas objektivave të formuluar

Faza 5: Hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit, i cili përcakton masat e kontrollit dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre, sipas afateve të parashikuara. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Gjatë procesit u vlerësuan:

- a) Fusha e menaxhimit financiar;
- b) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik;
- c) Fusha e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit që përfshin edhe zbatimin e legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- d) Fusha e shërbimeve publike;
- e) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave;
- f) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit;
- g) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve e të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Plani i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

1.2 Qasja Metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit për Bashkinë Patos u realizua në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke ndjekur një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore.

Instrumentet cilësore përfshinë:

1. *Analizën e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik* U shqyrtuan urdhrat, rregulloret, manualët, politikat e brendshme dhe dokumentet që lidhen me etikën, integritetin dhe funksionimin institucional, për të vlerësuar shkallën e zbatueshmërisë së tyre në praktikë.
2. *Diskutimet në grupe të fokusuara me stafin e bashkisë* U zhvilluan sesione me punonjësit e administratës, të cilët identifikuan proceset dhe funksionet më të ekspozuara ndaj riskut të korrupsionit dhe shkeljeve të integritetit, si dhe problematika që lidhen me burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike.

Instrumenti sasiore përfshiu:

Përdorimin e një *pyetësoi të strukturuar anonim*, të përgatitur dhe administruar me mbështetjen e ekspertëve të fushës, për të matur perceptimet e stafit mbi etikën, integritetin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në bashki. Pyetësoi u plotësua nga **punonjësit e bashkisë**, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave të kuantifikuara për risket potenciale.

Të dhënat e mbledhura nga analizat dokumentare, diskutimet në grup dhe pyetësoi u përpunuan për të identifikuar dhe vlerësuar intensitetin e risqeve, të cilat më pas u renditën sipas prioritetit dhe u trajtuan përmes një plani masash të dedikuar për menaxhimin e tyre.

2. Objektivat e identifikuar dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit

Vlerësimi i riskut të integritetit në bashki ndihmon institucionin në përcaktimin e strategjive, arritjen e objektivave dhe vendimarrje. Në analizimin dhe vlerësimin e riskut dhe praktikës institucionale për të gjitha fushat e veprimtarisë së bashkisë janë marrë parasysh fushat specifike si në vijim :

- Antikorrupsioni dhe mbrojtja e sinjalizueseve;
- Menaxhimi i Burimeve njerëzore dhe Kuadri ligjor e rregullator;
- Parandalimi i konfliktit të interesit;
- Transparenca, Informimi dhe
- Llogaridhënia, Etika dhe Imazhi i bashkisë.

Bashkia Patos ka në vizion të saj, funksionimin e një sistemi eficient të menaxhimit të integritetit, mbështetur në tre objektiva strategjike.

2.1 Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator, institucional dhe financiar në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Ky objektiv synon përmirësimin dhe përditësimin e rregulloreve të brendshme dhe akteve normative që rregullojnë funksionimin institucional të Bashkisë Patos. Bashkia ka hartuar dhe miratuar një kuadër të gjerë rregullash dhe dokumente strategjike për aspekte të veçanta të integritetit, të tilla si: Rregullore e Brendshme e Bashkisë, Rregullore për Sinjalizimin; Rregullore për Konfliktin e Interesit; rregulla për të drejtën për informim apo dokument politikash për mbrojtjen e privatësisë; Procedura Standarde Veprimi (PSV) për disa prej proceseve të punës në bashki. Megjithatë, rishikimi i Kuadrit Rregullator është i nevojshëm për të forcuar një kuadër rregullator efektiv, duke shtuar dispozita të caktuara, kryesisht ato që lidhen me aspektet dhe çështjet e integritetit, përditësimin me ndryshimet më të fundit ligjore, rregullimit të funksioneve dhe detyrave të njëjësive në bashki, si edhe pasqyrimin të ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale.

2.2 Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në Bashki, për parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit në të gjitha nivelet dhe funksionet

Ky objektiv përqendrohet në ndërtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Bashkisë Patos, duke garantuar një administratë efikase, të paanshme dhe të qëndrueshme. Synohet standardizimi i përshkrimeve të vendeve të punës, ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të rregullta dhe krijimi i një administrate që operon në përputhje me sistemin e meritës, profesionalizmit dhe etikës institucionale. Kjo mbështetet edhe nga përmirësimi i proceseve të rekrutimit, vlerësimit të performancës dhe zhvillimit në karrierë.

Nga vlerësimi i risqeve u konstatua se, megjithëse Bashkia Patos ka treguar përpjekje për ndarje proaktive të informacionit me publikun, programi i transparencës ka nevojë për tu përditësuar. Këto mangësi lidhen me nevojën për përditësimin dhe plotësimin e zërave të programit me informacione më të plota dhe më të detajuara.

2.3 Menaxhimi i riskut të integritetit për të gjithë bashkinë, me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë

Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut të integritetit është një element thelbësor i këtij plani. Fokus i veçantë i këtij objektiivi janë fushat më të ekspozuara ndaj risqeve, si menaxhimi financiar, administrimi i pronave, shërbimet publike, planifikimi i territorit dhe auditimi i brendshëm. Objektivi synon të krijojë një sistem efektiv për identifikimin e hershëm të problematikave, vendosjen e masave parandaluese dhe forcimin e kontrollit të brendshëm, duke garantuar një administrim transparent dhe të ndershëm të burimeve dhe proceseve vendore. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të integritetit në Bashkinë, është bërë sipas fushave funksionale të bashkisë, duke patur në konsideratë proceset dhe nënproceset kryesore të punës.

3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të trajtuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së Bashkisë Patos. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara.

Këto procese ndiqen nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit. Monitorimi kryhet rregullisht por jo më pak se një herë në vit. Raportimi i bën të mundur titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka hasur në vështirësi apo vonesa.

Objekti i 1: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti i lartë; Prioriteti i moderuar; Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
1	Mungon Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë.	Operacional/ Strategjik	1. Hartim	1. Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Patos. 2. Publikimi i këtij plani në Programin e Transparencës.	Grup Punë për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik Kordinatori për të Drejtën e Informimit (Gjashtëmujori i dytë 2026)

2	Mungojnë gjurmët e auditit për proceset me risk të lartë në bashki	Operacionet (Procesi)	Mesatar	1 Hartimi dhe miratimi i Gjurmëve të Auditit në përputhje me legjislacionin për menaxhimin dhe kontrollin financiar	Kryetari/Grup Pune Gjashtëmujori i parë 2026
3	Mungojnë PSV dhe rregullat e brendshme për proceset e punës në bashki	Operacionet (Procesi)	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i PSV dhe rregullave të brendshme për disa prej procesve kryesore si: 1. PSV për rekrutimin dhe procedurat e shpalljes së vendeve të lira 2. Rregullore për menaxhimin e dosjeve të punonjësve dhe ruajtjen e të dhënave personale 3. PSV për procedurën e zhvillimit të trajnimeve dhe përpilimin e planit vjetor të trajnimeve 4. PSV për administrimin e kontratave dhe detyrimeve financiare 5. PSV për menaxhimin e fondeve të veçanta/granteve të dedikuara 6. PSV për procedurën e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore 7. PSV për verifikimin dhe ndjekjen e detyrimeve të papaguara	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit Drejtoria e Financës Drejtoria e të Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit Sektori i Auditimit të Brendshëm Gjashtëmujori i dytë i 2025 e në vijimësi

				8. PSV për Hartimin dhe Zbatimin e Planit të Masave për Risket 9. PSV për Auditimet e Performancës	
4	Mungesë e Strategjisë së Administrimit të Pronave të bashkisë.	Operacional/Procesi		Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Strategjisë së Administrimit të Pronave të bashkisë.	Grup pune me punonjës të bashkisë i koordinuar nga një zv. Kryetar dhe Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin në bashki Gjashtëmujori i parë 2027
5	Mungesa e rregullave të brendshme për procesin e monitorimit të kontratave publike.	Operacional(Procesi)/ Ligjor dhe Kontraktual		1. Hartimi dhe miratimi i një PSV-je mbi metodat e monitorimit të kontratave publike. 2. Organizimi i trajnimeve të brendshme për stafin e përfshirë në monitorimin e kontratave publike, për të siguruar njohje sa më të mirë të PSV-së së miratuar.	Grup pune Gjashtëmujori i dytë i 2025 e në vijimësi
6	Specialistët e auditimit të brendshëm nuk janë të certifikuar.	Reputacional dhe Operacional		1. Mundësimi i trajnimit të personelit të Auditit të Brendshëm me qëllim marrjen e certifikimit përkatës .	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit dhe Sektori i Auditit të Brendshëm. Gjashtëmujori i parë i vitit 2022

7	Mungesa e Planeve e Detajuar vendore sipas prioriteteve në përputhje me Planin e Përgjithshëm vendor të miratuar për bashkinë.	Operacionet/Procesi		1. Hartimi i planeve të detajuara vendore sipas parashikimeve të bëra në Planin e përgjithshëm vendor. 2. Të kryhet konsultimi publik me të gjithë aktoret publike të interesuar, sipas dispozitave të Ligjit Per Njoftimin dhe Konsultimin Publik.	Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve + Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik Gjashtëmujori dytë 2026
8	Mungesë kapacitetesh dhe ndërgjegjësimi mbi procedurat standarde të PBA-së në nivel programesh dhe produkteve.	Operacional/Strategjik	Mesatar	1. Organizimi i sesioneve trajnuese/orientuese për drejtuesit e programeve mbi kryerjen e analizave bazuar në informacionin financiar dhe jofinanciar të viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual, si dhe procesin e kostimit. 2. Përfshirja e tyre në planin vjetor të trajnimeve.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit Drejtoria e Financës (Gjashtëmujori i parë 2026)

<i>Objektivi 2: Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashkë, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit</i>					
Nr	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti i lartë, Prioriteti i moderuar, Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
9	Nevojë për trajnime të vazhdueshme mbi ndryshimet e shpeshta ligjore/nëligjore në fushën e prokurimit publik.	Burime Njerëzore/ Operacional		1. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Legjislacionit, Sektori i Prokurimeve Publike, Sektori i Auditimit të Brendshëm, Drejtoria e Financës Gjyashëmujori i dytë i 2025 dhe në vazhdim
10	Hartimi i manualit të proceseve standarde të punës.	Burime Njerëzore/ Operacional	Mesatar	1. Plotësimi i manualit të përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune në bashki. 2. Informimi i punonjësve të bashkisë.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Legjislacionit dhe çdo drejtori. Gjyashëmujori i dytë i 2027

11	Nevojë për njohuri shtesë të punonjësve të njësisë së integritetit evropian lidhur me procedurat e aplikimit për përfitim të projekteve nga BE	Burime Njerëzore/Procesi	Mesatar	1. Ofrimi i trajnimeve të personelit në këtë fushë.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit Gjyashëmujori i dytë 2025 e në vijimësi
12	Mbingarkesa e punës në sektorin juridik dhe të prokurimeve mund të sjellë shkelje/mospërputhje ligjore me risk të lartë	Operacional/Procesi	Mesatar	1. Vlerësim i mundësisë së shtimit të stafit me profil jurist në Sektorin Juridik në përputhje me një analizë të ngarkesës së punës;	Drejtoria e Burimeve Njerëzore Gjyashëmujori i parë 2025 e në vijimësi
13	Mungesë transparence për rekrutimet e bëra për pozicionet vakante	Burimet Njerëzore	I moderuar	1. Të bëhet shpallja e të gjithë vendeve të lira të punës jashtë shërbimit civil në faqen zyrtare të Bashkisë dhe plotësimi i këtyre vendeve përmes Zyrës Vendore të Punësimit.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit + Koordinatorin për të Drejtën për Informim Menjërherë dhe në vijimësi.

<i>Objekti 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkësë;</i>					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti i lartë; Prioriteti i modëruar; Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
14	Bashkia nuk ka hartuar dhe publikuar raport monitorimi për programin e transparencës.	Operacionet (Procesi)	Mesatar	1.Miratimi dhe publikimi i Programit të Transparencës së bashkisë në përputhje me udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe legjislacionin përkatës. 2.Përditësimi i vazhdueshëm i Programit të Transparencës me informacionin e nevojshëm.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit/Sektorët përkatës të bashkisë Gjastëmujori i parë 2026 e në vijimësi.

15	Procesi i raportimit për drejtoritë e Aparatit të Bashkisë për realizimin e buxhetit, në periudha 4/8/12 mujore, është shumë teknik dhe financiar.	Operacional	i modernuar	1. Përcaktimi në rregulloren e brendshme të bashkisë i detyrimit për realizimin e mbledhjeve periodike nga Drejtuesi i Menaxhimit Financiar me drejtuesit e drejtorive ku të informohen, çdo 4 muaj, dhe shpjegohen në mënyrë më analitike për realizimin e buxhetit të bashkisë. 2. Hartimi dhe miratimi i një formati të brendshëm për përgatitjen e një informacioni analitik dhe të thjeshtë mbi realizimin e buxhetit.	1. Grup pune teknik me punonjës të bashkisë, për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Bashkisë, (i drejtuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit) Gjashtëmujori i dytë i 2026-it.
----	---	-------------	--------------------	--	--

16	Vendimmarrja për paketën fiskale e pambështetur në evidenca dhe analiza.	Operacional / Financiar	I moderuar	1. Konsultimi me grupet e interesit mbi përfitimet dhe përfitimet dhe kostot e paketës fiskale të propozuar. 2. Përcaktimi i një afati minimal për informimin e publikut të gjerë përpara miratimit të paketës fiskale. 3. Përcaktimi i këtij detyrimi në rregulloren e brendshme të bashkisë.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik , Taksave, Mjedisit dhe Turizmit Gjashtëmujori i dytë i 2025.
17	Mungesa e një programi të dedikuar financiar për administrimin e të dhënave financiare të bashkisë; përdorimi i skedarëve Excel për mbajtjen e të dhënave financiare, duke rritur riskun për gabime, mungesë gjurmueshmërie dhe pasiguri në ruajtjen e dokumentacionit.	Operacional/Procesi	Ushëruar	Propozimi dhe planifikimi për sigurimin e një programi financiar të certifikuar për administrimin dhe arkivimin e të dhënave financiare të bashkisë.	Drejtoria e Financës Gjashtëmujori i parë i 2026

18	Mungesa e manualeve të brendshme për procesin e mbikqyrjes dhe monitorimit të Shërbimeve publike.	Operationet (Procesi)	1 Lartë	1. Grup pune me punonjës të bashkisë për hartimin dhe miratimin e metodologjisë së monitorimit të performancës së shërbimit.	Grup pune Gjashtëmujori i dytë 2027
----	---	-----------------------	---------	--	--

Grupi i Punës

Koordinator
 Ernesta Hamiti

Anëtar
 Mimoza Shtëmbari

Anëtar
 Boreta Murati

Anëtar
 Juela Shpata

Anëtar
 Çajup Refitaj

KRYETARI
 Fation Duro

